



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS

MINISTRI

URDHËR

Nr. 250, datë 12/09/2014

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KËRKESAT TEKNIKE DHE
PROCEDURAT ADMINISTRATIVE NË LIDHJE ME EKIUPAZHIN
AJROR TË AVIACIONIT CIVIL SIPAS PARASHIKIMEVE TË
UDHËZIMIT TË MINISTRIT NR. 3, DATË 07.02.2011 "PËR
RREGULLAT E PËRBASHKËTA NË FUSHEN E AVIACIONIT CIVIL"

Në zbatim të Nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7 pika ç të Ligjit nr. 10040, date. 22.12.2008 "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar dhe në përputhje me Ligjin Nr.9658, datë 18.12.2006 "Për ratifikimin e Marrëveshjes Shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Shteteve Anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, për krijimin e një Zone të Përbashkët të Aviacionit Evropian",

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores "Për kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil sipas parashikimeve të udhëzimit të Ministrit nr. 3, datë 07.02.2011 "Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil".
2. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil për zbatimin e këtij Urdhri.
3. Urdhri i Ministrit nr. 35, datë 23.03.2012 "Për kriteret dhe procedurat e liçencimit të ekuipazhit fluturues, organizatave të trajnimit dhe seksioneve aeromjekësore AMC dhe AME", shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në fletoren zyrtare.

Edmond Haxhinasto

